

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Krijimi i sistemit informatik për menaxhimin e aboneve të pensionistëve”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Paketa software dhe sisteme informacioni (48000000-8), Pajisje skaner (30124500-9), Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacioni (72267100-0).

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **14,583,333** (katërmëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

*Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **157,063.36** (Njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e tre pikë tridhjetë e gjashtë) euro pa tvsh*

****Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14/08/2026 është 92.85 Lekë/Euro.***

Burimi i financimit: të ardhurat e Bashkisë Tiranë miratuar me VKB-në Nr. 100, datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028”si dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026 (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ose afati i zbatimit të kontratës: 27 (njëzet e shtatë) muaj kalendarik nga nënshkrimi i kontratës, ku 3 (tre) muaj do të jetë implementimi i sistemit dhe 24 (njëzet e katër) muaj do të jetë periudha e mirëmbajtjes së tij.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;*

*c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas **Shtojcës 1***

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen balance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.**

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit/ vlera e pritshme e kontratës së përlllogaritur për lot, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c dhe pika 5, si dhe neni 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Pika 2/a: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”. Vlera e përlllogaritur është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 5, “Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe kështu për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se:

“...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, citohet: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Për të garantuar implementimin me sukses të projektit, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të kontratës sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Telekomunikacion ose ekuivalente si dhe staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve (PMP / PRINCE 2) ose ekuivalente.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues SQL në nivelin profesional ose ekuivalente.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për zhvillimin e aplikacioneve software/web, si (Java Programmer OCP) ose ekuivalente.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Programming HTML5 with Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Testues Software.
- Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivelin Profesional ose ekuivalente.

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikatë dhe 5 (pesë) punonjësit e diplomuar në profilet Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Telekomunikacion ose ekuivalente, mund të disponojnë certifikatat e kërkuara.

Për punonjësit e mësipërm, operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Certifikatat/ dëshmi profesionale/diplomë për specialistët e kërkuar;
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 2 (dy) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave përkatëse) nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;

Argumentimi:

Kërkesa për staf sipas kërkesave të kriterit të sipërcituar është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4, ku citohet:

“ Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”

Fushat e përmendura të diplomimit sipas kërkesave të kriterit 4 janë pjesë e fushave të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, sikurse është dhe i fokusuar tërësisht projekti objekt prokurimi. Punonjësit e diplomuar në këto fusha dëshmojnë kanë njohuri teknike, aftësi për të përdorur teknologjitë e reja dhe për të sjellë inovacion në implementimin e platformës, të cilat janë të rëndësishme për ndërtimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit informatik. Përgjithësisht, kjo kërkesë për personel të diplomuar në fusha teknologjike ka për qëllim sigurimin e një ekipi me njohuri dhe aftësi të specializuara për të siguruar suksesin e implementimit të platformës dhe për të përmirësuar performancën dhe sigurinë e saj në të ardhmen. Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet realizimi i bërjes aktiv të shërbimit brenda afateve kohore të specifikuar në termat e referencës së kësaj procedure si dhe realizimi i shërbimit të vazhdueshëm të mirëmbajtjes, ku është e domosdoshme të parashikohen dhe rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve (PMP / PRINCE 2) ose ekuivalente.**

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti në fushën e menaxhimit të projekteve, PMP, PRINCE2 ose ekuivalente, lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin, fazat dhe afatet e realizimit të objektit të prokurimit.

Sipas Termave të Referencës, kontrata nuk përfshin vetëm zhvillimin e një aplikacioni, por realizimin e një projekti të plotë teknologjik, i cili përbëhet nga disa faza të ndërruara dhe që duhet të koordinohen brenda një afati 3-mujor për implementimin, të ndjekur nga 24 muaj mirëmbajtje.

Konkretisht, operatori ekonomik duhet të realizojë:

- analizimin dhe finalizimin e kërkesave funksionale dhe teknike;
- analizimin e dokumentacionit dhe proceseve ekzistuese të punës;
- bashkëpunimin me Bashkinë Tiranë, njësitë administrative dhe operatorët e transportit urban;
- paraqitjen skematike të proceseve të punës nëpërmjet diagrameve workflow;
- hartimin e planit të implementimit dhe përcaktimin e afateve të detajuara;
- projektimin, zhvillimin dhe konfigurimin e sistemit web;
- integrimin e sistemit me pajisjet ekzistuese dhe pajisjet e reja të skanimit OCR/MRZ;
- përcaktimin e kërkesave të infrastrukturës ku do të hostohet sistemi;
- importimin dhe kontrollin e të dhënave ekzistuese të pensionistëve në formatin CSV;
- testimin funksional, teknik, të performancës dhe të sigurisë së sistemit;
- organizimin dhe dokumentimin e testeve të pranimit;
- menaxhimin e korrigjimeve dhe ndryshimeve që lindin gjatë implementimit;
- instalimin e sistemit në infrastrukturën e Autoritetit Kontraktor;

- organizimin e trajnimeve për përdoruesit fundorë dhe administratorët teknikë;
- përgatitjen dhe dorëzimin e manualeve të përdorimit dhe dokumentacionit teknik;
- dorëzimin e kodit burimor, konfigurimeve dhe komponentëve të sistemit;
- menaxhimin e shërbimeve të suportit dhe mirëmbajtjes për 24 muaj sipas SLA-së;
- raportimin periodik mbi ecurinë, problematikat, ndërhyrjet dhe përmbushjen e kontratës.

Realizimi i këtyre shërbimeve kërkon koordinimin e disa profileve teknike, si analistë, zhvillues software, specialistë të bazave të të dhënave, specialistë të sigurisë së informacionit, specialistë sistemesh dhe personel suporti. Gjithashtu, kërkohet koordinimi i vazhdueshëm me disa struktura përfutuese dhe përdoruese të sistemit, të cilat kanë procese dhe përgjegjësi të ndryshme.

Menaxheri i projektit është i domosdoshëm për planifikimin dhe koordinimin e këtyre burimeve, ndarjen e detyrave, ndjekjen e afateve dhe rezultateve, administrimin e risqeve, problematikave dhe ndryshimeve, si dhe sigurimin e komunikimit të strukturuar ndërmjet operatorit ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor.

Roli i tij është veçanërisht i nevojshëm gjatë Fazës I – Faza përgatitore, ku duhet të përcaktohen grupet e punës, burimet njerëzore dhe materiale, hapat e zhvillimit, afatet konkrete, kërkesat përfundimtare të sistemit dhe proceset e punës. Dokumentet dhe vendimmarrjet e kësaj faze ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin, testimin dhe pranimin përfundimtar të sistemit.

Gjatë Fazës II – Zhvillimi i sistemit, menaxheri i projektit duhet të koordinojë zhvillimin e moduleve, integrimin me pajisjet e skanimit, përcaktimin e nevojave të infrastrukturës dhe importimin e të dhënave ekzistuese, duke garantuar që aktivitetet të realizohen në rendin dhe afatet e përcaktuara.

Gjatë Fazës III – Testimi, ai duhet të sigurojë planifikimin e testeve, regjistrimin dhe kategorizimin e problematikave, ndjekjen e korrigjimeve dhe përgatitjen e dokumentacionit të testeve të pranimi. Në fazat e trajnimit dhe dorëzimit përfundimtar, menaxheri duhet të koordinojë përdoruesit, materialet trajnuese, manualët, dokumentacionin teknik, kodin burimor dhe konfigurimet që do t'i kalojnë Autoritetit Kontraktor.

Certifikimet PMP dhe PRINCE2, ose certifikime ekuivalente, i garantojnë Autoritetit Kontraktor se Operatori Ekonomik disponon punonjës të certifikuar me njohuri dhe metodologji të strukturuar për menaxhimin e fushës së projektit, afateve, burimeve, cilësisë, komunikimit, risqeve, ndryshimeve dhe palëve të interesuara. Këto kompetenca janë të nevojshme për të garantuar që të gjitha fazat dhe produktet e kërkuara në Termat e Referencës të realizohen në mënyrë të koordinuar, të dokumentuar dhe brenda afateve kontraktuale.

Për rrjedhojë, kërkesa për një menaxher projekti të certifikuar është e lidhur drejtpërdrejt me shërbimet konkrete të kontratës, është proporcionale me kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e saj dhe synon të reduktojë rrezikun e vonësive, mungesës së koordinimit, ndryshimeve të pakontrolluara dhe mosrealizimit të produkteve brenda afatit.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente.**

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me shërbimet e suportit teknik dhe mirëmbajtjes së sistemit, të cilat do të ofrohen për

një periudhë 24-mujore pas marrjes së tij në dorëzim.

Sipas dokumentit të termave të Referencës, operatori ekonomik nuk ka vetëm detyrimin të zhvillojë dhe instalojë sistemin, por duhet të garantojë menaxhimin e vazhdueshëm të shërbimit. Konkretisht, operatori duhet:

- të ofrojë suport teknik dhe mirëmbajtje për 24 muaj;
- të trajtojë kërkesat dhe problematikat e raportuara nga Autoriteti Kontraktor;
- të evidentojë, kategorizojë dhe prioritzojë incidentet sipas niveleve kritike, të mesme dhe të ulëta;
- të respektojë kohët e reagimit, ndërhyrjes dhe zgjidhjes të përcaktuara në SLA;
- të konfirmojë marrjen e alarmeve madhore brenda 10 minutave;
- të kryejë diagnostikimin dhe riparimin në distancë ose në vend;
- të identifikojë dhe trajtojë shkaqet e përsëritjes së problematikave;
- të kryejë mirëmbajtje korrigjuese, parandaluese dhe proaktive;
- të kontrollojë periodikisht log-et, statistikën dhe performancën e sistemit;
- të menaxhojë në mënyrë të kontrolluar ndryshimet dhe përditësimet;
- të dokumentojë çdo ndërhyrje, duke evidentuar gjendjen para dhe pas saj;
- të raportojë mbi problematikat, ndërhyrjet dhe cilësinë e shërbimit.

ITIL Foundation vërteton njohuri bazë mbi praktikën e strukturuar të menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Këto praktika përfshijnë menaxhimin e incidenteve, kërkesave për shërbim, problemeve, ndryshimeve, niveleve të shërbimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Pra, plotësimi i kësaj kërkeje jep garanci më tepër që Operatori ekonomik garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes dhe termat e SLA-së. Një certifikim ITIL nuk është një premisë thjesht për një aktivitet suporti, por një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit.

Për rrjedhojë, disponimi i një specialisti të certifikuar ITIL Foundation ose ekuivalent është i nevojshëm për organizimin dhe administrimin e shërbimit të mirëmbajtjes sipas proceseve të njohura të menaxhimit të shërbimeve IT. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me detyrimet e mirëmbajtjes 24-mujore, SLA-në dhe proceset e raportimit të përcaktuara në Termat e Referencës.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave.**

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si administrator i bazave të të dhënave ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me funksionalitetet dhe të dhënat që do të administrohen nga sistemi objekt prokurimi.

Sipas dokumentit të termave të Referencës, sistemi do të mundësojë regjistrimin, përpunimin, ruajtjen, kërkimin, përditësimin dhe raportimin e të dhënave të pensionistëve, përdoruesve të sistemit, njësive administrative, operatorëve shpërndarës dhe aboneve të lëshuara. Për çdo pensionist

do të ruhen të dhëna të tilla si numri personal i identifikimit (NID), emri, mbiemri, datëlindja, gjinia, adresa, numri i telefonit, të dhënat e dokumentit të identifikimit, njësia administrative, statusi dhe historiku i pajisjes me abone.

Administratori i bazave të të dhënave është i nevojshëm për projektimin dhe administrimin e strukturës së bazës së të dhënave, përcaktimin e tabelave dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre, vendosjen e kufizimeve dhe kontrolleve të vlefshmërisë, si dhe garantimin e saktësisë, integritetit dhe konsistencës së informacionit.

Importimi i të dhënave ekzistuese në formatin CSV përbën një proces teknik me risk, pasi duhet të sigurohet hartëzimi i saktë i fushave, validimi i formateve, identifikimi i të dhënave të paplota ose të dublikuara dhe rakordimi i numrit të rekordeve para dhe pas migrimit. Përfshirja e një specialisti të certifikuar për administrimin e bazave të të dhënave zvogëlon rrezikun e humbjes, ndryshimit ose regjistrimit të pasaktë të informacionit.

Gjithashtu, sistemi do të përdoret nga disa kategori përdoruesish dhe duhet të realizojë kërkime, verifikime dhe raportime në kohë reale. Për këtë arsye nevojitet projektim dhe optimizim i përshtatshëm i bazës së të dhënave, duke përfshirë indeksimin, optimizimin e pyetjeve, kontrollin e transaksioneve dhe menaxhimin e burimeve, në mënyrë që rritja e volumit të të dhënave të mos shkaktojë ngadalësim ose ndërprerje të sistemit.

Për rrjedhojë, kërkesa për të paktën një administrator të certifikuar të bazave të të dhënave është e lidhur drejtpërdrejt me shërbimet objekt kontrate dhe është në propocion me natyrën e sistemit, volumin dhe rëndësinë e të dhënave që do të përpunohen, procesin e migrimit dhe periudhën 24-mujore të mirëmbajtjes.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues SQL në nivelin profesional ose ekuivalente.**

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues SQL në nivelin Profesional ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me funksionalitetet e sistemit që do të zhvillohet.

Sistemi objekt prokurimi do të administrojë një bazë të strukturuar të dhënash, e cila do të përmbajë të dhënat e pensionistëve, dokumenteve të identifikimit, përdoruesve, roleve, njësive administrative, operatorëve të transportit, aboneve mujore dhe veprimeve të kryera në sistem. Realizimi i këtyre funksionaliteteve kërkon ndërtimin e strukturave të përshtatshme të bazës së të dhënave dhe zhvillimin e komandave, procedurave dhe pyetjeve SQL për regjistrimin, përditësimin, kërkimin, verifikimin dhe raportimin e informacionit.

Ky specialist është i nevojshëm konkretisht për realizimin e kërkesave të mëposhtme të Termave të Referencës:

- modelimin dhe zhvillimin e strukturës së të dhënave të sistemit;
- krijimin e tabelave dhe marrëdhënieve ndërmjet pensionistëve, përdoruesve, operatorëve dhe aboneve;
- importimin dhe transformimin e të dhënave ekzistuese nga skedarët CSV;

- validimin dhe pastrimin e të dhënave gjatë migrimit;
- verifikimin automatik të qytetarit nëpërmjet numrit personal NID;
- parandalimin e regjistrimit të dyfishtë të të njëjtit pensionist;
- moslejimin e më shumë se një aboneje aktive për të njëjtin pensionist dhe të njëjtën periudhë;
- ruajtjen e historikut të regjistrimeve dhe shpërndarjes së aboneve;
- kërkimin dhe filtrimin sipas NID-së, emrit, mbiemrit, gjinisë, njësisë administrative, operatorit shpërndarës, muajit, vitit dhe statusit;
- gjenerimin e raporteve ditore, javore, mujore dhe vjetore;
- eksportimin e të dhënave në formatet Excel, CSV dhe PDF;
- regjistrimin dhe kërkimin e log-eve dhe gjurmëve të auditimit;
- optimizimin e pyetjeve të bazës së të dhënave për të garantuar kohë të përshtatshme përgjigjeje.

Procesi i regjistrimit dhe shpërndarjes së aboneve përmban edhe rregulla të rëndësishme të integritetit të të dhënave. Sistemi duhet të kontrollojë nëse pensionisti ekziston në bazën e të dhënave, nëse dokumenti i identifikimit është i vlefshëm, nëse pensionisti ka një abone aktive për muajin përkatës dhe nëse aboneja është tërhequr më parë. Zbatimi i këtyre kontrolleve kërkon zhvillim të saktë të logjikës së bazës së të dhënave dhe menaxhim të kontrolluar të transaksioneve.

Gjithashtu, moduli i raporteve kërkon kombinimin dhe përpunimin e të dhënave nga disa struktura të ndërlidhura. Përgatitja e pyetjeve SQL të sakta dhe të optimizuara është e nevojshme për të siguruar që raportet të paraqesin informacion të plotë, të saktë dhe pa dublikime, pa ndikuar negativisht në performancën e sistemit gjatë përdorimit të njëkohshëm të tij.

Certifikimi në zhvillimin SQL në nivel profesional ose ekuivalent provon se specialisti zotëron njohuri të avancuara në modelimin e të dhënave, zhvillimin e pyetjeve komplekse, procedurave të ruajtura, funksioneve, transaksioneve, validimin e të dhënave dhe optimizimin e performancës.

Për rrjedhojë, kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me funksionalitetet e regjistrimit, verifikimit, migrimit, raportimit dhe auditimit të përcaktuara në Termat e Referencës dhe është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e sistemit që do të zhvillohet.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për zhvillimin e aplikacioneve software/web, si (Java Programmer OCP) ose ekuivalente.**

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për zhvillimin e aplikacioneve software/web si (Java Programmer OCP) ose ekuivalente, lidhet drejtpërdrejt me objektin kryesor të kontratës, i cili përfshin projektimin, zhvillimin, konfigurimin, testimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të ri informatik web për menaxhimin e aboneve të pensionistëve.

1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për zhvillimin e aplikacioneve software/web, si (Java Programmer OCP) ose ekuivalente. Është i nevojshëm për realizimin e shërbimeve dhe funksionaliteteve konkrete të mëposhtme:

- zhvillimin e ndërfaqes së administratorit;
- zhvillimin e moduleve të përdoruesve, roleve dhe të drejtave të aksesit;

- zhvillimin e modulit për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të pensionistëve;
- realizimin e kërkimit dhe identifikimit të pensionistëve nëpërmjet NID-së dhe dokumentit të identifikimit;
- zhvillimin e logjikës për kontrollin e regjistrimeve të dyfishta;
- moslejimin e më shumë se një aboneje aktive për të njëjtin pensionist;
- zhvillimin e procesit të aktivizimit dhe konfirmimit të marrjes së abonesë;
- zhvillimin e modulit të raporteve dhe eksportimit në formatet Excel, CSV dhe PDF;
- integrimin e aplikacionit me pajisjet ekzistuese dhe të reja OCR/MRZ për skanimin e kartave të identitetit dhe pasaportave;
- implementimin e mekanizmave të autentikimit, autorizimit dhe kontrollit të aksesit sipas roleve;
- implementimin e historikut dhe auditimit të veprimeve të përdoruesve;
- zhvillimin e funksioneve për importimin masiv të të dhënave ekzistuese;
- trajtimin e gabimeve, validimin e të dhënave dhe afishimin e mesazheve të konfirmimit;
- optimizimin e aplikacionit për përdorim nga një numër i lartë përdoruesish;
- korrigjimin dhe përmirësimin e kodit gjatë testimit dhe mirëmbajtjes 24-mujore;
- dokumentimin dhe dorëzimin e kodit burimor tek Autoriteti Kontraktor.

Certifikimi profesional provon se specialisti zotëron njohuri të strukturuar në programimin e orientuar nga objektet, zhvillimin e logjikës së aplikacionit, trajtimin e gabimeve, aksesin në bazat e të dhënave, sigurinë e aplikacionit dhe ndërtimin e komponentëve të mirëmbajtshëm dhe të ripërdorshëm.

Kompetencat e këtij specialisti janë të nevojshme edhe për integrimin e sistemit me pajisjet skanuese nëpërmjet driver-ave, SDK-ve, API-ve ose mekanizmave ekuivalentë, në mënyrë që të dhënat e dokumenteve të identifikimit të lexohen dhe të plotësohen automatikisht në sistem.

Gjithashtu, duke qenë se Autoritetit Kontraktor do t'i dorëzohet kodi burimor i plotë, i strukturuar dhe i komentuar, nevojitet që zhvillimi të realizohet sipas praktikave profesionale të programimit, me ndarje të qartë të komponentëve, dokumentim teknik dhe mundësi mirëmbajtjeje e zhvillimi të mëtejshëm.

Për rrjedhojë, kërkesa për një specialist të certifikuar në nivel profesional për zhvillimin e aplikacioneve software/web është e lidhur drejtpërdrejt me shërbimet e zhvillimit, integritetit, testimit, dokumentimit dhe mirëmbajtjes të përcaktuara në Termat e Referencës dhe është proporcionale me objektin e kontratës.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në Programming HTML5 with Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.**

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në zhvillimin e ndërfaqeve web me HTML5, JavaScript dhe CSS3 ose ekuivalent lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe funksionalitetet e sistemit objekt prokurimi, i cili, sipas Termave të Referencës, duhet të ofrohet tërësisht në formën e një aplikacioni web.

Sistemi do të aksesohet nëpërmjet shfletuesve të internetit dhe do të përdoret nga kategori të ndryshme përdoruesish, përfshirë administratorët e sistemit, punonjësit e njësive administrative,

operatorët shpërndarës dhe punonjësit përgjegjës për raportimin. Për këtë arsye kërkohet zhvillimi i ndërfaqeve të qarta, funksionale, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për proceset që do të kryejë secili rol.

Specialisti i zhvillimit front-end do të jetë i nevojshëm për realizimin e shërbimeve dhe funksionaliteteve konkrete të mëposhtme:

- zhvillimin e ndërfaqes së autentikimit dhe aksesit në sistem;
- ndërtimin e ndërfaqes së administratorit për menaxhimin e përdoruesve, roleve dhe të drejtave;
- zhvillimin e formularëve për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të pensionistëve;
- paraqitjen automatike të të dhënave të lexuara nga karta e identitetit ose pasaporta;
- validimin e fushave të detyrueshme dhe kontrollin e formatit të të dhënave;
- afishimin e mesazheve për gabime, paralajmërime dhe veprime të suksesshme;
- krijimin e dritareve të konfirmimit për regjistrimin, aktivizimin, çaktivizimin ose fshirjen e të dhënave;
- zhvillimin e funksioneve të kërkimit dhe filtrimit sipas NID-së, emrit, mbiemrit, njësisë administrative, statusit dhe periudhës;
- ndërtimin e ndërfaqes së operatorit shpërndarës për identifikimin e pensionistit dhe konfirmimin e dhënies së abonesë;
- paraqitjen e raporteve, listave dhe rezultateve të kërkimit;
- përshtatjen e menuve dhe nënmenuve sipas roleve dhe të drejtave të përdoruesve;
- sigurimin e funksionimit të ndërfaqes në shfletuesit e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor;
- optimizimin e ndërfaqes për përdorim të shpejtë dhe të thjeshtë nga punonjësit e sporteleve.

HTML5 përdoret për strukturimin semantik të ndërfaqes dhe formularëve të aplikacionit; CSS3 për paraqitjen, organizimin vizual dhe përshtatjen e ndërfaqes; ndërsa JavaScript mundëson ndërveprimin dinamik me përdoruesin, validimin e të dhënave, kërkimin, filtrimin, dritaret e konfirmimit dhe komunikimin ndërmjet ndërfaqes dhe shërbimeve të aplikacionit.

Këto kompetenca janë të rëndësishme për këtë kontratë, pasi proceset e regjistrimit dhe shpërndarjes do të realizohen nga përdorues me role dhe nivele të ndryshme njohurish teknike. Një ndërfaqe e ndërtuar në mënyrë profesionale redukton gabimet gjatë hedhjes së të dhënave, shkurton kohën e shërbimit dhe ndihmon në përdorimin e njëtrajtshëm të sistemit nga njësitë administrative dhe operatorët shpërndarës.

Certifikimi i kërkuar provon se specialisti zotëron njohuri të strukturuar në zhvillimin e ndërfaqeve web, ndërtimin dhe validimin e formularëve, manipulimin e elementeve të ndërfaqes, trajtimin e veprimeve të përdoruesit, komunikimin me shërbimet e aplikacionit dhe sigurimin e përputhshmërisë me shfletues të ndryshëm.

Për rrjedhojë, kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me detyrimin për zhvillimin e një sistemi tërësisht web-based dhe me modulet konkrete të përdoruesve, roleve, regjistrimit, shpërndarjes dhe raportimit të parashikuara në Termat e Referencës. Ajo është proporcionale me natyrën e kontratës dhe synon të garantojë cilësinë teknike dhe përdorshmërinë e ndërfaqes së sistemit.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar si Testues Software.**

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si Testues Software lidhet drejtpërdrejt me Fazën III – “Faza e testimit të sistemit”, të përcaktuar shprehimisht në Termat e Referencës, si dhe me detyrimin e operatorit ekonomik për të zhvilluar, testuar, optimizuar dhe dorëzuar një sistem të qëndrueshëm, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat funksionale dhe teknike.

“Faza III – Faza e testimit të sistemit.

- *Gjatë kësaj faze do të kryhen testimet. Do të jetë detyrë e stafit të autorizuar të Bashkisë Tiranë (komisionit/grupit të punës), Njësive Administrative dhe Operatorët e Transportit Urban që të përcaktojnë vlefshmërinë e proceseve, funksioneve dhe të sistemit në tërësi.*
- *Dorëzimi i testeve të pranimit.”*

Punonjësi i certifikuar si Testues Software është përgjegjës për përgatitjen dhe kryerjen e testeve, evidentimin e problematikave, verifikimin e korrigjimeve dhe përgatitjen e testeve të pranimit që do t’i dorëzohen Autoritetit Kontraktor. Certifikimi provon njohuritë profesionale të nevojshme për realizimin dhe dokumentimin e këtij procesi, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së sistemit me kërkesat e Termave të Referencës.

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivelin Profesional ose ekuivalente.**

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivel profesional ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me kërkesat e dokumentit të termave të Referencës për instalimin e sistemit në infrastrukturën IT të Bashkisë Tiranë dhe aksesimin e tij në mënyrë të sigurt nga kategori të ndryshme përdoruesish, përfshirë administratorët, punonjësit e njësive administrative dhe operatorët e transportit urban.

Një punonjës i certifikuar për Sigurinë e Rrjeteve në nivelin Profesional ose ekuivalente është i nevojshëm për konfigurimin e sigurt të komunikimit në rrjet, përcaktimin e rregullave të aksesit, mbrojtjen nga ndërhyrjet dhe akseset e paautorizuara, si dhe monitorimin e problematikave që mund të cenojnë funksionimin e sistemit. Ky rol lidhet gjithashtu me kërkesat e TOR-it për autentikimin e përdoruesve, kontrollin e aksesit sipas roleve, ruajtjen e log-eve dhe garantimin e disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave.

Certifikimi në nivel profesional provon se punonjësi zotëron njohuritë e nevojshme për identifikimin dhe trajtimin e risqeve të sigurisë së rrjetit dhe për mbrojtjen e komunikimit ndërmjet përdoruesve, sistemit dhe infrastrukturës ku ai do të hostohet. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur me shërbimet konkrete të instalimit, konfigurimit, sigurimit dhe mirëmbajtjes së sistemit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a) Standartin ISO 9001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Standartin ISO 27001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).*

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentimi:

Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Neni 44 - Kërkesat e cilësisë, pika 1, ku citohet:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

a) Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e ofrimit të shërbimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga ofruesi i shërbimit, fokusi i klientit, përshtatshmëria e burimeve të tij, kompetenca, profesionalizmi i punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimi i cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimeve që ofron,

garantimi i një procesi cilësor të furnizimit, sigurimi i konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin.

Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Referuar sa më sipër, kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 27001 është një kuadër standartizues përsa i përket garancisë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër, ky standard i kërkuar, lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi operatori ekonomik do të realizojë shërbimin e instalimit dhe konfigurimeve të nevojshme për vijueshmërinë e shërbimit të internetit e intranetit, dhe shërbimin e mirëmbajtjes së vazhdueshme përgjatë afatit të kontratës, për të garantuar mbarëvajtjen e proceseve teknologjike të punës, shërbime të cilat domosdoshmërisht kërkojnë akses në infrastrukturën e autoritetit. Aksesit në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë për të realizuar shërbimet sa më sipër do të jetë i kontrolluar e monitoruar nga stafi i Bashkisë, megjithatë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme që kërkohet.

c) Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Standardi mbulon procese që lidhen drejtpërdrejt me këtë kontratë, përfshirë:

- menaxhimin e incidenteve dhe kërkesave për shërbim;
- menaxhimin e problemeve dhe identifikimin e shkaqeve të tyre;
- menaxhimin dhe kontrollin e ndryshimeve në sistem;
- menaxhimin e niveleve të shërbimit dhe respektimin e SLA-së;
- menaxhimin e disponueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimit;
- menaxhimin e kapaciteteve dhe performancës;
- monitorimin, matjen dhe raportimin e cilësisë së shërbimit;
- dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e ndërhyrjeve;
- përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara.

Certifikimi ISO 20000-1 (ose ekuivalente), ofron siguri se operatori ekonomik disponon një sistem

të dokumentuar menaxhimi, role dhe përgjegjësi të përcaktuara, procedura për regjistrimin, kategorizimin, përshkallëzimin dhe zgjidhjen e incidenteve, si dhe mekanizma për monitorimin e performancës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit.

Shënim:

1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të

referencave për procedurën e këtij objekti, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); V.K.B-së Nr. 131 dt 18.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2025”; grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e investimit.

Specifikimi i parametreve teknik etj:

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar te njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Krijimi i sistemit informatik për menaxhimin e aboneve të pensionistëve”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.